



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0922

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “Infinit” SH.P.K. kundër Vendimit për anulimin e procedurës së prokurimit të Komuna Suharekë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi, mirëmbajtja dhe Servisimi i klimave për drejtorit e komunave, shkollat dhe qerdhet” me numër të prokurimit: 624-25-6392-1-2-1, me 05/11/2025, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE “Infinit” SH.P.K. me nr. 2025/0922, e datës 18/09/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi, mirëmbajtja dhe Servisimi i klimave për drejtorit e komunave, shkollat dhe qerdhet” me numër të prokurimit: 624-25-6392-1-2-1.
2. Anulohet njoftimi për dhënie të kontratës, ndërkaq aktiviteti i prokurimit “Furnizimi, mirëmbajtja dhe Servisimi i klimave për drejtorit e komunave, shkollat dhe qerdhet” me numër të prokurimit 624-25-6392-1-2-1 kthehet në Rivlerësim.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik “Infinit” SH.P.K.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 15/07/2025, Komuna Suharekë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi, mirëmbajtja dhe Servisimi i klimave për drejtorit e komunave, shkollat dhe qerdhet” me numër të prokurimit

624-25-6392-1-2-1.

Ndërsa me datën 05/09/2025 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontrate OE AS Tech SH.P.K.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 30,000.00 €

Me 08/09/2025, OE “Infinit” SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 18/09/2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Infinit” SH.P.K. me nr. 0922/2025 lidhur me aktivitetin “Furnizimi, mirëmbajtja dhe Servisimi i klimave për drejtorit e komunave, shkollat dhe qerdhet” me numër të prokurimit:624-25-6392-1-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

OSHP ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Infinit” SH.P.K. janë parashtruar si në vijim:

Neni 1- Qellimi Neni 6- Ekzaminimi dhe Efikasiteti Neni 7- Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi Neni 52- Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës Neni 59- Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tendereve Neni 60- Kriteret për dhenie të kontratës Neni 61- Tenderët Jo-Normalisht të Ulët Neni 63- Siguria e ekzekutimit Neni 40 i Rregullores për prokurim publik- Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tendereve. Neni 41 i Rregullores për prokurim publik- Tenderët Jo-normalisht të Ulët.

AK/Komisioni vlersues gjatë vlerësimit të ofertave për projektin në fjalë nuk ka vepruar në harmoni me LPP Nr. 04/L-042 I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 përkatësisht dispozitat ligjore të lartëcekura dhe Udhëzimin operativ të rregulloren për prokurim publik. AK/zyra e prokurimit me 05.09. ka nxjere njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues dhe ka rekomanduar për kontrate OE Astech sh.p.k. Kompania jone eshte eliminuar me arsyetimin, citoj: AK me date 01.09. ka kerkuar sqarim per pozicionin 12 i cili eshte cilesuar me cmim jonormalisht te ulet, ku ka kerkuar spjegim te hollesishem dhe te dokumentuar per elementet e cmimit (koston e furnizimit, instalimit, garancionit dhe servisimit). Andaj pergjigjen e pranuar nga ana juaj nuk eshte bindese per komisionin e vleresimit te ketij aktiviteti, pasi qe nuk ka spjegim te hollesishem per kete pozicion. Ky konstatim i AK/komisionit vlersues nuk qendron, AK na eshte drejtuar me 01.09. ne ora 15:42 me Letër standarde e kerkeses per informata mbi tenderet jo-normalisht te ulet dhe me 02.09. ne ora 08:12 i kemi derguar autoritetit kontraktues deklaraten/sqarime shtese per te konfirmuar se qendrojme prapa ofertes se dorezuar dhe projektin do te realizojme ne harmoni me

kerkesat e parashtruara nga AK ne dosjen e tenderit dhe paramase. Poashtu per te faktuar se oferta e kompanise sone nuk eshte jo-normalisht e ulet ne kemi bashkangjitur oferten e pranuar nga distributori i klimave Chigo per Kosove me te cilen deshmojme se oferta e kompanise sone nuk eshte jo-normalisht e ulet dhe kemi marzhe fitimi ne totalin e paramases reth 20% bruto. Ne kontraten e shohim si teresi, megjithese mund te kete cmime te uleta per pozicione te caktuara furnizimet do te realizojme ne teresi (cilesi dhe sasi) sipas kerkesave te parashtruara ne ANEKS 1 te dosjes se tenderit. Strategjia e vendosjes se cmimeve percaktohet nga menaxhmenti i kompanise duke mare parasysh koston e blerjes se produkteve dhe prodhimin e tyre. Per te deshmuar ekonomicitetin e ofertes dhe profitin nga kjo kontrate ne kemi bashkangjitur oferten nga furnitori i klimave te cilen e kemi pranuar per kete aktivitet te prokurimit para dates se ofertimit. Konform nenit 41.3 te Rregullores per prokurim publik oferta e kompanise sone nuk mund te cilesohet si jo-normalisht e ulet pasi qe nuk plotesohet kushti nr. 1 citoj: 41.3 Autoritetet kontraktuese do te kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar për tenderët e përgjegjshëm, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme: i. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm; Konkretisht per pozicionin 12 te cilit AK i referohet ne leter standarde ne kemi sqaruar se keto klima i kemi ne stok dhe jemi ne gjendje ti plasojme me cmim nen kosto vetem te bejme shitjen kete vit pasi qe vitin tjeter na mberrijne modele te reja te klimave dhe keto aktuale e kemi me te veshtire ti plasojme. Pasi qe ne kemi ofruar deshmi- fakte te mjaftueshme se oferta e kompanise sone nuk eshte jo-normalisht e ulet konform nenit 61.2 te LPP-se dhe nenit 41.8 te Rrrpp-se AK ka mund te veprone konform nenit 63.2 perkatesisht 63.3 te LPP-se duke kerkuar sigurimin e ekzekutimit ne vlere me te larte deri ne 50% pasi qe neni 63.2 nuk kufizon perqindjen e lejuar te sigurise se ekzekutimit e cila duhet te ofrohet me rastin e nenshkrimit te kontrates. Kjo parashihet dhe ne vendimet e OSHP-se per situata te njejta ne te kaluaren, citoj vendimin nr. 554/23 te dates 24.11.2023. ku PSH nxjere konkluzion:

Paneli Shqyrtues sa i perket pohimeve ankimore OE i rekomanduar ka ofruar çmime jonormalisht te ulëta duke u bazuar në të dhënat e këtij aktiviteti, të llojit të procedurës së hapur, konstaton se, OE ankues nuk ka ofruar dëshmi argumente dhe të dhëna konkrete që dërgojnë të vërtetimi i pretendimit apo klasifikimin e tij si i bazuar, ndërsa mbete në diskrecion e AK-së (sipas dispozitave të LPP-së) që në këtë rast, duke pasur parasysh instrumentet ligjore që mund ti përdorë para dhe përgjatë implementimit të kontratës, siç janë rritja e sigurimit të ekzekutimit, menaxhimi i saj sipas kriterëve standardeve të përcaktuara paraprakisht, e po ashtu bazuar në çmimet e ofertuara të krijojë bindjen se oferta e OE të rekomanduar nuk ka hapësirë manipulimesh si dhe krijim të vështirësive në implementim të kontratës. Ne pasi qe jemi te sigurte se do te realizojme projektin ne teresi sipas kushteve dhe kerkesave te parashtruara ne njoftimin per kontrate dhe ne dosjen e tenderit jemi ne gjendje qe me rastin e nenshkrimit te kontrates te ofrojme garanci/ sigurimin e ekzekutimit ne vleren totale te ofertes prej 25,743.00euro per te siguruar AK qe sigurimi të tillë që do të jetë e barabartë me dëmet dhe shpenzimet që autoriteti kontraktues parashikon se do ti ketë në rast të shkeljes së kontratës nga operatori ekonomik. AK/Zyra e prokurimit nder te tjera ka vepruar jashteligjshem pasi qe nuk ka njoftuar KRPP konform nenit 61.5 te LPP-se per nje vendim te tille, citoj: 4. Autoriteti kontraktues është i obliguar për të njoftuar KRPP-në brenda dy ditëve që nga data e ndonjë refuzimi nën nenin paragrafit 4. të këtij neni. Njoftimi duhet të ofrojë informacionin, shpjegimet dhe arsyet e përmendura në atë nen. Ne shkresat e lendes dhe raportin e vleresimit nuk eshte cekur se AK ka njoftuar KRPP per vendimin e nxjere konform nenit 61.4 te LPP-se. Autoriteti kontraktues KK Suhareke ka udhehequr procedure per furnizim me klima dhe ne vitin 2023 dhe 2024 ne procedurat me nr prokurimit 624-23-5527-2-3-6 perkatesisht 624-24-5776-2-2-1 ku ne te dy kontratat eshte lidhur kontrate me OE Astech sh.p.k. OE i njejte i rekomanduar edhe ne

kete procedure tenderimi. AK ne ato projekte nuk ka cilesuar si oferte jo normalisht te ulet cmimet e dhena nga kompania ne fjale, citoj vetem disa pozicione pasi qe jane deshmi relevante me kete aktivitet per te cilin po parashtrojme ankese: Kontrata e lidhur ne vitin 2024 Mbushja me gas e klimav 18BTU- 35euro Mbushja me gas e klimav 60BTU- 5euro Klima 60BTU e cila kosto te mbushjes mbi 100euro eshte ofertuar me cmim 7fish me te ulet se mbushja e klimes 18BTU Kontrata e lidhur ne vitin 2023 Mbushja me gas e klimav 9-12BTU – 40euro Mbushje me gas e klimav 48BTU- 15euro Rasti i nejte ku klima e cila ka kosto te mbushjes mbi 100euro eshte ofertuar me 15euro ndersa klima e cila ka kosto te mbushjes 25euro eshte ofertuar 40euro. Por si duket keto cmime ne ate kohe kane qene reale-normale per autoritetin kontraktues dhe nuk ka pasur hapesire per zhvillimin e procedures inter-partes/ trajtimin e ofertes se OE te rekomanduar si jo-normalisht e ulet. Keto fakte vertetojne se AK/ Zyra e prokurimit ka diskriminuar kompanine tone dhe eshte duke punuar me standarde te dyfishta. AK megjithese ne kete procedure nuk e ka bere vleresimin e ofertave ne proporcion me vleresimet (historikun) e kontratave furnizim me klima te cilat jane lidhur ne vitin 2023,2024 ndersa ne pergjigje te kerkeses per ri-shqyrtim ka cekur se per te arritur te keto konkludime ka vleresuar dhe historikun e permbushjes se kontratave ku eshte cekur nje kontrate e cila nuk eshte realizuar plotesisht ne vitin 2023 nga 9 pozicione te kontrates per 3 pozicione paisje motorike ne nuk kemi arritur ti sigurojme dhe kemi derguar deshmi nga prodhuesi se keto produkte nuk prodhohen me dhe deshtimi i implemetimit ne teresi ka ardhe pa fajin tone. Pjesa tjeter eshte permbushur, vlere e kontrates ka qene 8750.00euro dhe eshte realizuar mbi 70% apo 7105.00euro. Kompania jone ka realizuar ne perpikeri 4 kontrata tjera pas kesaj periudhe (Furnizim me paisje laboratorike per shkollen Abdyl Ramaj, Furnizim me mjete konkretizimi per kabinete, Furnizim me material per praktike profesionale ne shkollen Skender Luarasi, Furnizim me smart board ne shk Skender Luarasi per te cilat AK na ka leshuar reference pozitive. Mare parasysh faktet e lartecekura konstatojme se AK/komisioni vleresues ka vepruar jashte-ligjshem duke eliminuar oferten e kompanise sone megjithese kemi plotesuar te gjitha kushtet dhe kriteret e percaktuara nga AK ne dosjen e tenderit.

9. Dëmet materiale

Si pasoje e shkeljeve te lartecekura nga AK/komisioni vleresues ka ardhe deri tek eliminimi i ofertes se kompanise sone pa te drjete ne kete menyre nuk jane respektuar dispozitat ligjore te lartecekura, kompanise sone i eshte mohuar e drejta e fitimit te nje kontrate publike megjithese kemi qene oferta e pergjegjshme me cmimin me te ulet te dorezuar ne kete aktivitet te prokurimit, ne anen tjeter eshte demtuar buxheti publik perkatesisht KK Suhareke per 4232.00euro duke u rekomanduar per kontrate oferta me cmimin me te larte te dorezuar brenda buxhetit te percaktuar nga AK ne kete aktivitet te prokurimit. Kerkojme nga Organi shqyrtues i prokurimit qe pas shoshitjes se provave dhe fakteve te aprovoje ankesen e kompanise sone si te bazuar dhe lenda te kthehet ne ri-vleresim.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 19/09/2025 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0922/2025, ndërsa me datë 05/10/2025 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 0922/2025, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lenda të kthehet në rivlerësim.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE "Infinit" SH.P.K. eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0922 ka vlerësuar si në vijim:

Përgjigje në Pretendimin nr. 1.

OE "INFINITT " SH.P.K., Dëshmorët e Kombit, 10000, PRISHTINË, pretendon se A.K., Autoriteti Kontraktues KOMUNA SUHAREKË, nuk e ka respektuar qëllimin e nenin 1 të LPP-së .

Ekspertja thekson se ndër tjera qëllim i këtij neni është ti udhëzoj autoritetet kontraktuese që të sigurojnë menyrë ma efikase ,më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike ,duke përcaktuar kushtet rregullat që do të zbatohen , procedurat që do të ndiqen ,te drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen,si dhe të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik.

AK e ka trajtuar kërkesën për rishyrtim të OE ankues si të pa bazuar,me arsyetimin se oferta e OE ankues konsiderohet si ofert jo-normalisht të ulët.

Edhe pas deklaramentit të OE se se për pozicionin 12 të paramases,malli gjindet në stok,persëri AK e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të OE ankues.

Ekspertja është e mendimit se qëndron pretendimi i OE ankues ,ndërsa arsyen ma te detajuar do ta gjeni më posht .

Andaj ,Ekspertja konstaton se ky pretendim është i bazuarë.

Përgjigje në Pretendimin nr. 2.

OE "INFINITT " SH.P.K., pretendon se Autoriteti Kontraktues KOMUNA SUHAREKË, nuk e ka respektuar nenin 6 të LPP-së .

Ekspertja sqaron se ndër të tjera qëllimi i nenit 6 të LPP-së është të udhëzohen autoritetet

kontraktuese të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, fondet publike dhe burimet publike që janë ofruar ose që janë vënë në dispozicion sipas një kontrate publike mund të përdoren vetëm nga kontrata e tillë dhe vetëm për qëllimet e të njëjtës.

AK e ka trajtuar OE ankues si të eliminuar ,sepse në ofertën e dorëzuar ka një pozicion me çmim ab-normalisht të ulët, që do të thotë që sipas AK ky pozicion nuk është në harmoni me çmimet e tregut.

Me datë 01.09.2025 AK-ja kishte kërkuar sqarim shtesë nga Operatori ekonomik Ankues edhe pas deklarimit nga OE ankues dhe pas sqarimeve se i gjithë malli gjindet në stok, AK nuk e ka vlerësuar –shqyrtuar me vemendje përgjigjejen e OE ankues ,sepse vetëm blanko e ka refuzuar

pa dalur në teren dhe pa verifikuar mallin se a gjindet në stok dhe a është sipas kërkesave të AK së të parapara në aneksin e dosjesë së tenderit , e eliminon operatorin ekonomik,e kjo bie ndesh me nenin e permendur më lartë.

AK e ka trajtuar OE ankues si të eliminuar, sepse oferta e dorëzuar nuk ishte në harmoni me çmimet e tregut ,dhe këtë AK e bën pa hulumtim të tregut të paktën në shkresat e lëndës nuk gjindet ndonjë dokument që AK ka tentuar të paktën të bëjë një hulumtim për pozicionin 12 .

Andaj,

Ekspertja konstaton se ky pretendim është i bazuar .

Përgjigje në Pretendimin nr. 3 nr.5, nr. 7, nr. 8 , nr. 9 dhe nr. 10.

OE "INFINITT " SH.P.K., pretendon se Autoriteti Kontraktues KOMUNA SUHAREKË, nuk e ka respektuar nenin 7,neni 59 neni 61 dhe 63 të LPP-së ,si dhe neni 40 dhe 41 të RRPP-së

Ekspertja thekson se ndër të tjera qellim i këtij neni (neni 7 i LPP-së) është të udhëzojë autoritetet kontraktuese se duhet ti trajtojë të gjithë operatorët ekonomik në menyrë të barabartë pa diskriminim si dhe me transparencë, gjatë udhëheqjes së procedurave të prokurimit .

Ekspertja thekson se ndër tjer qellim i nenit 59 te LPP-së dhe 40 te RRPP-së është te udhezojë AK për Ekzaminim ,vlerësim dhe Krahësim e tenderëve ,fillimisht autoriteti kontraktues ka themeluar komision të vlerësimit dhe i njeiti komision ka dhenë rekomandim ,gjithashtu rekomandimi është aprovuar nga udhëheqësi i prokurimit .

Ekspertja thekson se ndër tjer qellim i nenit 61 te LPP-së dhe 41 të RRPP-së është te udhezojë AK për Ekzaminim ,vlerësim dhe Krahësim e tenderëve lidhur me çmimet të cilat duhet vlerësuar se a janë në harmoni me çmimet e tregut apo janë jo normalisht te ulëta.

Ekspertja thekson se ndër tjer qellim i nenit 63 te LPP-së është të udhezojë AK për sigurinë e ekzekutimit dhe sqaron mundësin e rritjes edhe gjatë vlerësimit.

Pretendimi i OE ankues ndër të tjera se:

AK/Komisioni vlersues gjatë vlerësimit të ofertave për projektin në fjalë nuk ka vepruar në harmoni me LPP Nr. 04/L-042 I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 përkatësisht dispozitat ligjore të lartëcekura dhe Udhëzimin operativ e rregulloren për prokurim publik.

AK/zyra e prokurimit me 05.09. ka nxjere njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues dhe ka rekomanduar per kontrate OE Astech sh.p.k.

Kompania jone eshte eleminuar me arsyetimin, citoj:

AK me date 01.09. ka kerkuar sqarim per pozicionin 12 i cili eshte cilesuar me cmim jo-normalisht te ulet, ku ka kerkuar spjegim të hollesishem dhe te dokumentuar per elementet e cmimit (koston e furnizimit, instalimit, garancionit dhe servisimit). Andaj pergjigjen e pranuar nga ana juaj nuk eshte bindese per komisionin e vleresimit te ketij aktiviteti, pasi qe nuk ka spjegim te hollesishem per kete pozicion.

Ky konstatim i AK/komisionit vleresues nuk qendron, AK na eshte drejtuar me 01.09. ne ora 15:42 me Letër standarde e kerkeses per informata mbi tenderet jo-normalisht te ulet dhe me 02.09. ne ora 08:12 i kemi derguar autoritetit kontraktues deklaraten/sqarime shtese per te konfirmuar se qendrojme prapa ofertes se dorezuar dhe projektin do te realizojme ne harmoni me kerkesat e parashtruara nga AK ne dosjen e tenderit dhe paramase. Poashtu per te faktuar se oferta e kompanise sone nuk eshte jo-normalisht e ulet ne kemi bashkangjitur oferten e pranuar nga distributori i klimave Chigo per Kosove me te cilen deshmojme se oferta e kompanise sone nuk eshte jo-normalisht e ulet dhe kemi marzhe fitimi ne totalin e paramases reth 20% bruto.

Ekspertja sqaron se sa i perket pretendimit të OE ankues vlersimi i ofertave nuk është bërë në harmoni me udhëzimet e dispozitave të lartpërmendura, sepse AK edhe pas kërkesës për sqarim shtesë do të duhej që ta vlerësoj, vertetoj deklaratën e OE ankuse se dhënë për pozicionin 12.

Ekspertja mendon se ky pretendim është i bazuar, sepse AK në këtë rast do duhej ta vlerësonte deklaratën e OE ankues duke pas parasysh se ishte ofertues me çmim ma të lirë, dhe sipas udhëzimeve të dispozitave të lartcekura ka qenë e obliguarë të ndërmerr veprime tjera sa i perket vlerësimit të ofertave dhe gjatë gjithë vlerësimit do të duhet të respektoheshin edhe kriteret e dhëna në njoftim për kontrat dhe dosje të tenderit, dhe vlerësimi të ishte në harmoni edhe nenin 1 ,nenin,7 nenin,59 dhe nenin 61 të LPP-së , Autoritetit Kontraktues keto dispozita i japin shumë mundësi jo vetëm mundësi por edhe e obligojnë të ndërmarr veprime si hulumtim të tregut , verifikimin e mallit në stok që OE anku ka deklaruar se i posedon ,pra vlerësimi ,ekzaminimi nuk nenkupton të bëjë vlerësim vetëm në zyretë e AK por i njëjti duhet të luaj rol aktivë dhe të bëjë vlerësim të plotë të aktivitetit të prokurimit, kur OE ankues deklaroi se e posedon mallin në stok dhe të njëjtin ua sjell me të njëjten ofertë, AK ka edhe një mekanizëm tjetër në dispozicion sikurse e ka përmendur edhe OE ankues ka të drejtë ta rrisë sigurinë e ekzekutimit e cila është mundësi që e siguron AK në përmbushjen e kontratës , pasi që kemi të bëjmë me furnizim, e që nenkupton se furnizimi bëhet përnjëherë e jo pjesë pjesë që në rastin konkretë do të rrezikohet mospërmbushja e ndonjë pjese të kontratës, pra nuk mundë të eliminohet OE ankues pa i shfrytëzuar mundësi që ja japin dispozitat e lartcekura .

Andaj,

Ekspertja konstaton se keto pretendime janë të bazuara.

Përgjigje në Pretendimin nr. 4.

OE "INFINITT " SH.P.K., pretendon se Autoriteti Kontraktues KOMUNA SUHAREKË, nuk e ka respektuar nenin 52 të LPP-së

Ekspertja thekson se ndërë të tjera qellim i këtij neni është ti udhëzojë autoritetet kontraktuese se në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit do të specifikoj kriteret që do të përdoren për dhënie të kontratës.

Kriteret duhet të jenë ose çmimi më i ulët ose tenderi ekonomikisht më i favorshëm.

Vetëm kriteret e matshme dhe të cilat paraprakisht janë përcaktuar në dosjen e tenderit mund të shfrytëzohen për vlerësim. Autoriteti kontraktues mund të përdorë vetëm kritere që janë relevante në mënyrë direkte me lëndën e kontratës. Kritere të tilla janë por nuk kufizohen në lidhje me: cilësinë, çmimin, meritat teknike, estetike, dhe karakteristikat funksionale, karakteristikat e mjedisit, shpenzimet rrjedhëse, efektiviteti i kostos, shërbimet e pas-shitjes dhe asistencë teknike.

Ekspertja sqaron se legjislacioni i prokurimit edhe kjo dispozite nderlidhet me pretendimin nr 1 dhe pasi pretendimi 1 është i bazuar vlen pergjigjeja e dhenë në pergjigjejen 1 te ketij raporti.

Andaj,

Ekspertja konstaton se ky pretendim është i bazuar .

Përgjigje në Pretendimin nr. 6.

OE "INFINITT " SH.P.K., pretendon se Autoriteti Kontraktues KOMUNA SUHAREKË, nuk e ka respektuar nenin 60 të LPP-së

Ekspertja thekson se ndërë të tjera qellim i kesaj dispozitave është ti udhëzojë autoritetet kontraktuese se si të vendosin kriterin per dhenjen e kontrates dhe ne para 1.1 percaktohet si:

tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

Ekspertja thekson se kjo dispozitë nderlidhet me dispozitat e tjera , dhe do të thot që është e bazuar sepse OE ankues është ofertuesi me çmim ma te lire, dhe është eliminuar pa nderrmarrjen e veprimeve që e obligon ligji sikurse u sqarua në pergjigjejet paraprake te ketij raporti.

Andaj,

Ekspertja sqaron se ky pretendim është i bazuar.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit“Furnizimi, mirëmbajtja dhe Servisimi i klimave për drejtorit e komunave, shkollat dhe qerdhet” me numër të prokurimit 624-25-6392-1-2-1.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues te cilave ju a fal besimin, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik aprovohet si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull“Furnizimi, mirëmbajtja dhe Servisimi i klimave për drejtorit e komunave, shkollat dhe

qerdhet” me numër të prokurimit 624-25-6392-1-2-1, të anulohet njoftimi për dhenie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim si dhe AK të veproj në harmoni me dispozitat ligjore të LPP-së dhe kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA SUHAREKË**
- **OE - " INFINITT " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: